



**MEMORANDUM PËR BASHKËPUNIMIN DHE SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT  
NË FUSHËM E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE SHËRBIMEVE POSTARE.**

**NDËRMJET**

**ZYRËS SE TELEKOMUNIKACIONIT TE ÇEKISË  
CTU**

**DHE**

**AUTORITETIT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE,  
AKEP  
REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

Zyra e Telekomunikacionit të Çekisë, CTU dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, AKEP

Në vazhdim referuar si “Pjesëmarrësit”,

**Duke dëshiruar** krijimin e kushteve të përshtatshme për promovimin e mëtejshëm të aktiviteteve dhe marrëdhënieve miqësore midis Pjesëmarrësve,

**Duke njohur** rëndësinë e rritjes së vazhdueshme të sektorit të komunikimeve elektronike dhe ndikimi i tij në zhvillimin ekonomik për secilin vënd,

**Duke pasur në konsideratë** rëndësinë e rregullimit efektiv të sektorit të komunikimeve elektronike,

**Të Bindur** se ky Memorandum do të kontribuojë në zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Çekisë dhe Republikës së Shqipërisë duke siguruar mbështetjen sa i përket zhvillimit të sektorit të komunikimeve elektronike.

Kanë rënë dakort si vijon:

### **Qëllimi i Memorandumit**

- Ky Memorandum jo detyrues mund të lehtësojë bashkëpunimin në fushën e komunikimit elektronik nëpërmjet mbështetjes dhe zbatimit të masave të përbashkëta, shkëmbimit të informacionit dhe të përvojës në rregullim.

### **Fusha e Bashkëpunimit**

Në vazhden e progresit të shpejtë të sektorit të komunikimeve elektronike shtrirja e këtij bashkëpunimi mund të përcaktohet me pëlqimin e ndërsjelltë, bazuar në synimin e Pjesëmarrësve për të realizuar sa më poshtë:

- Për të ndërmarrë të gjitha masat e mundshme për të thjeshtëzuar zhvillimin e sektorit të komunikimeve elektronike në vëndet përkatëse të Pjesëmarrësve:
- Për të mundësuar rritjen efektive të cilësisë së shërbimeve të telekomunikacionit:
- Shkëmbimin e informacionit mbi strategji specifike dhe mekanizma të bashkëpunimit aktiv në kuadër të projekteve të përbashkëta në fushën e komunikimeve elektronike: për të zhvilluar konsultime reciproke nëse Pjesëmarrësit e konsiderojnë të përshtatshme:
- Për të siguruar ekspertë dhe specialistë të përshtatshëm si dhe marrjen e masave për të organizuar takime të përbashkëta, seminare, workshop dhe simpoziume në fushën e komunikimeve elektronike:

Pjesëmarrësit mund të vazhdojnë dialogun reciprok me qëllim krijimin brënda sferës së aktivitetit të tyre, të kushteve të favorshme për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis dy Autoriteteve Kombëtare Rregullatore, Zyrës së Telekomunikacionit të Çekisë (CTU) dhe Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).

**Nënshkruar në Pragë më \_\_\_\_/\_\_\_\_ 2016 në tre kopje autentike, secila në gjuhën Çeke, Shqip dhe Anglisht. Në rast mosmarrëveshje për interpretimin e Memorandumit, varianti i tij në Anglisht do të këtë përparësi.**

**Për**  
**Zyrën e Telekomunikacionit të Çekisë**  
**(CTU)**

---

**Jaromír Novák, M.Sc.**  
**(Kryetar)**

**Për**  
**Autoritetin e Komunikimeve Elektronike**  
**dhe Postare**  
**(AKEP)**

---

**Piro Xhixho.**  
**(Kryetar)**